



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .02.2021

**MBLEDHJA Nr. 07,
datë 11.02.2021, ora 10:30
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkzionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkzionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 11.02.2021, ora 10:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 07 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a., për shtyrjen e hyrjes në fuqi të vendimit nr. 202 datë, 02.12.2020, për miratimin e “Rregullores për procedurat e shitjes së tepcave të energjisë elektrike në tregun e parregulluar për shoqërinë publike të furnizimit”
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Janar 2021
3. Mbi heqjen e licencës nr. 359, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “E N P I” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 36, datë 06.03.2017
4. Mbi heqjen e licencës nr. 384, seria T17, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Energy to Energy” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 06.09.2017
5. Mbi heqjen e licencës nr. 405, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Malsia Solar 1” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 105, datë 30.04.2018
6. Mbi heqjen e licencës nr. 406, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Malsia Solar 2” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 106, datë 30.04.2018

7. Mbi heqjen e licencës nr. 407, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Malsia Solar 3” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 107, datë 30.04.2018
8. Mbi heqjen e licencës nr. 348, seria T16, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Nordic Invest Group” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 121, datë 21.07.2016
9. Mbi heqjen e licencës nr. 413, seria F18, për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 126, datë 04.06.2018
10. Mbi heqjen e licencës nr. 398, seria T18, për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 12.03.2018
11. Mbi plotesimin e kushtit të vendimit nr. 114, datë 22.07.2019 “Mbi licencimin e shoqërisë “S.P.E. Gjadër” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Gjadër nr. 1/1” me kapacitet të instaluar 2134 kW, Hec “Gjadër nr. 1/2” me kapacitet të instaluar 4406 kW, Hec “Gjadër nr. 2” me kapacitet të instaluar 2983 kW, Hec “Gjadër nr. 3”, me kapacitet të instaluar 3874 kW, Hec “Gjadër nr. 4” me kapacitet të instaluar 5922 kW, Hec “Gjadër nr. 5” me kapacitet të instaluar 5619 kW, me kapacitet total të instaluar 24938 kW, i ndryshuar
12. Çështje të tjera

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI